

**VENDIM**  
**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**“BLUE POINT PETROLEUM” Sh.P.K.**

Sot, me date 06.09.2013, ora 10:00, ne seline e Shoqerise “Blue Point Petroleum” Sh.P.K. (“Shoqeria”), shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne baze te Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr. 22438, date 15.12.1999, me NUIS/NIPT K01318005N, me seli ne adresen Rruga “Medar Shtylla”, Nr. 6/442, Pallati 5, Ap. 32, Tirane, u mbledh Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te Shoqerise.

Jane te pranishem ne mbledhje ortaket qe zoterojne 100% (njqind perqind) te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise si me poshte vijon:

- Z. Laert Duraj, zoterues i 40% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise, i pranishem personalisht.
- “A & M” Sh.P.K., zoteruese e 60% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, e perfaqesuar rregullisht nga Perfaqesuesi i saj Ligjor Z. Elidon Malaj.

Duke qene se jane te pranishem ortaket qe zoterojne te gjitha kuotat e kapitalit me te drejte vote, ne perputhje me Nenin 83/2 te Ligjit 9901/2008, te ndryshuar, ortaket shprehen dakord per te proceduar ne miratimin e vendimeve te vlefshme, pavaresisht se mungon nje akt formal thirrjeje per mbledhjen ne fjale.


Ortaket vendosin te kryesoje mbledhjen ortaku Z. Laert Duraj, i cili pranon kryesimin dhe cakton si mbajtes te ketij procesverballi Z. Elidon Malaj, Perfaqesues Ligjor i ortakut “A & M” Sh.P.K., i cili pranon detyren dhe vijon me mbajtjen e procesverballit.

Mbledhja e Asamblese mbahet ne vijim te propozimit te Administratorit te Shoqerise per anulimin e kuotes se Ortakut A&M Sh.P.K.

Ortaket pasi u njohen me propozimin e Administratorit dhe diskutuan ne lidhje me te, ne baze te dhe ne perputhje me Nenin 81/1/f te Ligjit 9901/2008, te ndryshuar, unanimisht,

**VENDOSEN:**

1. Te miratojne anulimin e kuotave te zoteruara nga Ortaku “A & M” Sh.P.K. ne kapitalin themeltar te Shoqerise duke percaktuar vleren e drejte te likuidimit te tyre ne shumen prej EUR 1.200.000;
2. Te miratojne zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise nepermjet anulimit te kuotave te ortakut “A&M” Sh.P.K. gjithsej 2.571.978,00 (dy milione e peseqind e shtatedhjete e nje mije e nenteqind e shtatedhjete e tete) kuota me vlere te pergjithshme nominale prej 257.197.800,00 Leke, duke njoftuar per kete Qendren Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me procedurat ligjore te zbatueshme;
3. Me anulimin e kuotave dhe zvogelimin e kapitalit, Shoqeria ngelet shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem, me kapital themeltar prej 171.465.200,00 (njqind e shtatedhjete e nje milione e katerqind e gjashtedhjete e pese mije e dyqind) Leke, i ndare ne 1.714.652,00 (nje milione e shtateqind e katermbedhjete mije e gjashteqind e pesedhjete e dy mije) kuota me vlere nominale prej



100,00 (njqind) Leke, te zoteruara teresisht nga Ortaku i Vetem Z. Laert Duraj.

4. Autorizohet Administratori i Shoqerise qe ne perputhje me kerkesat dhe procedurat ligjore, te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme per zbatimin e ketij Vendimi si dhe te kryeje njoftimet perkatese prane Regjistrat Tregtar ne lidhje me anulimin e kuotes dhe zvogelimin e kapitalit sipas percaktimeve te ketij Vendimi.

Miratuar dhe nenshkruar rregullisht si me poshte vijon:

**Kryetari**  
**Laert Duraj**

**Mbajtesi i Procesverbalit**  
**Elidon Malaj**

